

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR
“KATERIN ALBANIA” SH.P.K**

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “KATERIN ALBANIA” sh.p.k është themeluar në bazë të aktit të themelimit sipas Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar me Ligjin Nr 10475, datë 27.10.2011 dhe me Ligjin 129/2014, datë 02.10.2014, si dhe në Ligjin 9723. Datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar me Ligjin Nr.9916, datë 12.05.2008, me Ligjin Nr.92/2012, datë 27.09.2012 dhe me Ligjin Nr.8/2015, datë 19.02.2015 dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Parashikimet e këtij Statuti zbatohen për një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K)

Në këtë Statut:

- Ligji është Ligji Nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar me Ligjin Nr 10475, datë 27.10.2011 dhe me Ligjin 129/2014, datë 02.10.2014;
- “Statuti” është Statuti i Shoqërisë;
- QKB- Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri.

Sot, më 07 Shtator 2021 une themeluesia:

Keti Xhagjika, e bija e Ylli-it , nenshtetase italiane,e datëlindjes 04.05.1976, lindur në Tirane, dhe banuese në Itali,Roma.N 18. me numer leternjoftimi nr. AU7187429, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ne cilësinë e ortakut te vetem te shoqërisë “Katerin Albania” sh.p.k.

Neni 1

Emri dhe Forma Juridike

- 1.1 Emri dhe emertimi tregtar i Shoqërisë është “Katerin Albania” SH.P.K.
- 1.2 Shoqëria “Katerin” Sh.p.k. është një person juridik privat, themeluar në bazë të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (me pas referuar si “Ligji”) në formën e shoqërisë me përgjegjesi te kufizuar.
- 1.3 Shoqëria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare te Biznesit (me pas referuar si “QKB”) në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Neni 2
Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

-Ne imobilare shit-blerje, qiramarje-qiradhenje pronash te pa tundshme.

Neni 3
Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat te pacaktuar kohor.

Neni 4
Selia, Adresa

- 4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tirane,Tirane ,Njesia administrative Nr.10,Rruga Sami Frasheri,Pallati Titan,Kati1,H.04.
- 4.2 Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është “nuk ka”.
- 4.3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon xhosauditing@gmail.com Cel:+ 0699696200;
- 4.4 Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet hapjes së degëve dhe zyrave të përfaqësimit. Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësi

mit bëhet sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët e shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Neni 5
Kalimi i kuotave me trashëgimi (Mortis Causa) ose për shkak të Falimentimit të ortakeve.

- 5.1 Në rast vdekje apo falimenti, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit të ortakeve.
- 5.2 Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të ortakeve mund të zgjedhë të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.

Kreu II
Kapitali i Regjistruar

Neni 6
Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 6.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njqind mije) Lekë.
- 6.2 Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj deri ne limitin e percaktuar me ligj, me vendim te Ortakeve.
- 6.3 Kapitali fillestar i shoqerise “Katerin Albania” Sh.p.k eshte 100.000 (njqind mije) leke.
- 6.4 Kapitali eshte i ndare ne një kuotë të vetme 100% e cila eshte ne zoterimin e ortakut te vetem:
- Keti Xhagjika zoteruese e nje kuote te vetme te plote 100% me vlere nominale 100.000 leke.(njqind mije)

- 6.5 Ortaket kane të drejtë të tjetërsojë këtë kapital, të shtojnë apo të pakesojë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji.
- 6.6 Ortaket miratojne llogarite, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, merr vendim per ndryshimet qe mund te pesoje statuti, per ndryshimin e mases se kapitalit themeltar dhe shdnerrimin e shoqerise ne nje forme tjetere, per punesimin e punonjesve dhe pagat, si dhe probleme te tjera te lidhura me punesimin ne zbatim te legjislacionit shqiptar etj. Vendimet e Ortakeve evidentohen ne nje regjister.

Neni 7

Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

- 7.1 Administratori mund ti kërkojë ortakeve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera (në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara.
- 7.2 Zotëruesi i kuotes do të jete përgjegjës dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

Neni 8

Certifikatat e kuotave

- 8.1 Ortaket e shoqërisë kanë të drejtë të përfitojnë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tyre. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

- 9.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 9.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 10.1 Ortakët, mund të zmadhojnë dhe të vendosin zvogëlimin për kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e veta përcaktuar në vendimin përkatës.

Neni 11

Hetimet e posaçme

- 11.1 Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Kreu III **Administratori**

Neni 12 **Emërimi i Administratorit**

- 12.1** Ortaket emërojnë një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 12.2** Administratori i një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të Nenit 207 të Ligjit 9901, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 12.3** Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i shoqërise.
Administratori i parë i shoqërisë caktohet znj Keti Xhagjika, e bija e Ylli-it , nenshtetase italiane,e datëlindjes 04.05.1976, lindur në Tirane, dhe banuese në Itali,Roma.N 18. me numer leternjoftimi nr. AU7187429, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ne cilësinë e administrators se shoqërisë “Katerin Albania” sh.p.k.

Neni 13 **Kompetencat e Administratorit**

- 13.1** Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 13.2** Administratori thekret Ortakët, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë,
 - shoqëria propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë.
- 13.3** Nëse ortakët, emërojnë më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Ortakët mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 14 **Shpërbërja dhe likuidimi**

- 14.1** Shoqëria mbaron me vendim të Ortakëve ose kur ka një prishje të parakoheshme për arsye të parashikuara në ligj.

Neni 15

Viti Financiar

- 15.1** Viti financiar i Shoqërisë fillon 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2** Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 16 **Kontrolli Financiar**

- 16.1** Kontrolli financiar I Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 17 **Bilanci Vjetor**

- 17.1** Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrative mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Ortakët e shoqërisë.
- 17.2** Shoqëria është e detyruar të dorëzojë bilancin brenda afateve të caktuara në ligjin mbi kontabilitetin.

Neni 18 **Perfaqesimi**

- 18.1** Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.
- 18.2** Administratori, që përfaqëson shoqërinë tregtare, mund të autorizojë persona të tjerë për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.
- 18.3** Njoftimet e drejtuara secilit administrator janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
- 18.4** Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tij njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Kreu VI **Prishja dhe njoftimet**

Neni 19 **Prishja dhe likuidimi**

- 19.1** Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të ortakëve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - e) me vendim të gjykatës;
- 19.2** Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.
- 19.3** Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me Nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 20
Njoftimet

- 20.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 20.2 Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratori në faqen e internetit të shoqërisë).

Neni 21
Punesimet ne Shoqeri

- 21.1 Per punonjesit qe do te punesohen, marredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen me kontraten e punes ne perputhje me dispozitat ligjore dhe Kodin e Punes.

Neni 22

- 22.1 Shoqeria merr persiper te derdh rregullisht te gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesuarve te saj ne organet kompetente perkatese sipas ligjit.

Neni 23
Gjuha

- 23.1 Ky Akt Themelimi u nënshkrua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 24
Zgjidhja e mosmarreveshjeve

- 24.1 Te gjithë mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit, do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente.

Neni 25
Dispozita përfundimtare

- 25.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë Akt themelimi dhe Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr.9901 i datës 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut

K.ETI...XHAGJIKA .


Keti Xhagjika

Une 2. Xhoi Pjetri jam i autorizuar nepermjet nje prokure te pergjithshme me Nr 1242 dhe Nr 264 Per te kryer cdo veprim ne institucionet publike